



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



PROCESVERBAL I MBAJTJES SË MBLEDHJES DYTË TË KKSB-së
PËR VITIN 2018

REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Prishtinës nga Policia e Kosovës;
3. Informatë lidhur me përgatitjet për fushatën e korrje-shirjeve në territorin e Komunës.
4. Kthimi i qytetarëve tanë me banim dhe punësim të përkohshëm në botën e jashtme për pushime, çështja e sigurisë në qytetin e Prishtinës;
5. Të ndryshme.

Selim Pacolli nënkryetar i Komunës e hapi mbledhjen duke i përshëndet të pranishmit, dhe i njoftojë me rendin e ditës. Po ashtu tha se edhe konkluzionet e mbledhjes së kaluar i kemi shqyrtuar dhe se janë marre parasysh edhe shqetësimin e stacionit policor të Veriut lidhur me kushtet e vështira të punës ku si pasoje e tyre ka pas edhe sëmundje të rënda dhe së shpejti në bashkëpunim edhe me drejtorit përkatëse do të bëhet caktimin e lokacionit për stacionin policor.

Pika e parë e Procesverbalit i mbledhjes së kaluar të ditës u miratua nga të pranishmit të KKSB-së.

Fatmir Bilalli - tha se në mungesë të Drejtorit të DSHPMSh do të informojnë dy shefat e SHP-së bazë të konkluzioneve të mbledhjes së kaluar paraqiti masat që janë ndërmarr lidhur me ankesat: në Fshatin Siqevë për gropat e hapura kemi ndërmarrë masa dhe e kemi sanuar gjendjen në mënyrën më të mirë të mundshme, pastaj ndriçimi është paraqit si problem në rrugë publike dhe afër institucioneve fetare kemi ndërmarrë masa për zgjerimin e ndriçimit në bazë të kontratës sidomos me prioritet për institucionet fetare.

Sa i përket problemit me qentë endeçak ne kemi kompaninë e kontraktuar e cila është duke kryer shume punë. Pastaj ankesa tjetër lidhur me hapjen e puseve në qytet, ne kemi dalë në terren me inspektoret dhe e kemi rrethuar vendin me rrethoje ose shirita për rrezik. Problem tjetër ka qenë edhe gjendja e keqe në zhvesh torën e stadiumit në Bardhosh ku lenden e kemi përcjellë në Drejtorin ne e Kulturës

Pika e dytë e rendit të ditës, Informatë lidhur me gjendjen e sigurisë në Komunën e Prishtinës nga P.K. në këtë pikë të rendit të ditës raportuan tre Komandantet e stacioneve të Policisë.



Bekim Zogjani – komandat i stacionit policor qendra i cili tha: sa i përket zonës së sigurisë e vlerësojmë të qetë, nuk ka prishje të mëdha të rendit kemi një rënie të aksidenteve në komunikacion prej 7% dhe 3% për aksidentet e rënda dhe gjobat prej 40%. Sa i përket zonës verore ne kemi planin operativ të policisë intern ku përfshihet edhe periudha e korrje-shirjeve, ndërsa në të ndryshe do të paraqes problemet që kemi has me mes qytetareve dhe BVI-së.

Gani Berisha- Komandant i stacionit policor të jugut kemi hartuar plane operative të cilat po kanë efekt në parandalimin e veprave penale ku kemi rënie 20% në veprat penale kundër pasurisë edhe në veprat tjera në përgjithësi ka rënie në statistika.

Safet Jashari- Komandanti i stacionit policor të veriut shfrytëzoi rastin të falënderojë edhe një herë angazhimin e nënkryetarit Selim Pacolli për përcaktimin e lokacionit për ndërtim të Stacionit Policor -veriut ku gjendja është e rënde dhe kushtet të mjerueshme të punës dhe se kjo gjendje është prej shumë vitesh. Raportet e sigurisë është e qetë dhe ka përmirësime në të gjitha nivelet duke përfshirë edhe angazhimin e policeve civil neper shkolla dhe me stafin arsimor kemi një bashkëpunim shumë të mirë rreth masave parandaluese për qeshjen e sigurisë. Kemi marrë disa masa shtese për angazhimin të stafit për ta ngritur nivelin e sigurisë në nivel të lartë me rastin e festes së Videvanit që të mos ketë hapësirë për ndonjë ekces.

Hetem Kupina- pati një kërkesë nga FSK për të kontrolluar në fshatin Bardhosh pasi kanë hapur një porte kanë gjetur gëzhoja të minave.

Safet Jashari Komandant i Policisë së Veriut- nëse ka rrezik duhet se pari policia të njoftohet sepse kemi ekipin e specializuar për deminim pastaj mund të vijnë edhe ekipet e FSK-së për ndihmë sepse kemi bashkëpunim.

Hetem Kupina i paraqiti kërkesat për drejtorit përkatëse faktorët që ndikojnë në cenimin e sigurisë dhe që janë përgjegjësi e Komunës- DSHPMSH.

-Vërshimet nga të reshurat atmosferike si pasojë e mospastrimit të tre lumenjëve; Prishtevka, Bernica dhe Llapi; Qenet endacak; mungesa e shenjave të komunikacionit rrugor; mungesa e ndriçimit në shumë rrugë; djeponit ilegale të mbeturinave, duhet të punohet në parandalimin e tyre; transportimi i qytetareve nga transportues ilegal (të palicencuar); ndotja e ambientit (ndezja e gomave dhe gjëseneve të tjetra (mungon preventiva) varrosja e kafshëve të ngordhura në vende ku mund të rrezikohen qytetarët.

Kërkesat për Drejtorinë e Arsimit:

Mungesa e kamerave ose rojeve në shkollë; vendosja e rrethojave në shkollë; vendosja e pengesave në rrugë para shkollave; bartja e nxënësve me mjete të dyshuara; posedimi i nxënësve me mjete të rrezikshme si thika, boksa, shufra metali, armë zjarri etj. Mungon edukimi për të parandaluar; mungesa e ujit të mjaftueshëm në shkollë; rrezik nga kundërmimet në tualet etj, zgjidhje ka (puset); rrezik nga qëndrimi i të papunëve në oborrin dhe lokacionet e shkollës; rrezik nga përdoruesit e drogës (të organizohen trajnime për parandalim me njohës të kësaj fushe; mungesa e psikologut neper shkollë të cilat kanë mbi 1000 nxënës; plani strategjik dhe plani i veprimit të përgatitet nga Drejtoria në fjalë.

Pika e trete - Informate lidhur me përgatitjet për fushatën e korrje-shirjeve në territorin e Komunës

Shkëmbi Gashi informoj se komuna e Prishtinës ka bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e korrje-shirjeve, planifikohet që të fillojë me 5 korrik por kjo varet edhe nga kushtet atmosferike me drithë janë të mbjellë ura 972 hektarë; grurë 10 hektarë dhe priten rendimente

4000 kg për hektarë, janë të angazhuar 47 auto-kompanja të cilët te vjetërsuar, është formuar komisioni komunal për mbikëqyrje te punës në këtë përbërje : Yll Demolli, Gani Dobratiqi, Muharrem Beka ,Behar Krasniqi dhe Labinot Kryeziu .

Ilmi Vitia përfaqësues i KLSP-së Hajvali e dëgjova raportin e korrje-shirjeve dhe ju pyes sa a kane paraparë për ti ndihmuar bujqit me shpenzimet e naftës për arsye se edhe janë shtrenjtuar derivatet e naftës .

Shkëmbi Gashi vitin e kaluar nuk ishte parapare ne buxhete shpenzimet e naftës ,kështu që ne vetëm e realizojmë projektin e vitit të kaluar , ne do të shqyrtojmë mundësinë qe ti planifikojmë për vitin e ardhshëm.

Selim Pacolli -nënkryetar i Komunës tha se ne bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë do të shqyrtojmë mundësin për subvencionuar bujqit .

Hetem Kupina - Përfaqësuesi i Bujqësisë tha se janë bere te gjitha përgatitje për korrje-shirjeve ,por nuk ka subvencione për bujqit .

Shkëmbi Gashi- tha se unë prezantova procedurën ,përcaktimin e komisionit ndërsa fermerët janë ata që bëjnë punën profesionale .

Pika e katërt kthimi i qytetarëve tanë me banim dhe punësim të përkohshëm në botën e jashtme për pushime, çështja e sigurisë në qytetin e Prishtinës

Lulzim Vrapca Udhëheqës i Komuniteti për Kthim presim integrim për personat e riatdhesuar , MPB ka 20 mijë te kthyer ndërsa 4500 palë përfituese, sa i përket këtij viti ka pas progres ku Komisioni Evropian e ka vlerësuar pozitiv këtë fushë. Sfidë për Komunën e Prishtinës ka qenë decentralizimi i financave. Ministria ka pasur një Strategji për integrim e personave qe janë kthyer nga vatrata e luftës si në Siri apo vend tjetër nga MPB na është thënë se nuk kemi kapacitete të mjaftueshme për të angazhuar psikolog ,sociolog në rehabilitim për personat e kthyer. Riatdhesimi ne qeshjen e punësimit po ka ngecje nga niveli qendror qytetaret po presin një vite për ta krye trajnimin profesional për integrim në tregun e .Plani i biznesit mase e planit strategjik, çdo muaj i raportojo kryetarit për rrjedhën e këtij procesi .

Pika e peste - të ndryshme

Vesë Kelmendi përfaqësuese e shoqërisë civile paraqiti një sere kërkesash duke filluar nga çështja e parkingjeve kryetari ka pas prezantua një plan te mire por nuk është aprovuar as nga kjo qeveria e as qeveritë tjera të kaluar. Pastaj ajo paraqiti shume shqetësuese edhe qeshjen e menaxhimit të mbeturinave edhe pse janë disa kompani të angazhuara ende gjendja është e keqe hedhja e mbeturinave edhe jashtë kontejnerëve gjithashtu kërkojë pastrimin - larjen e rrugëve me gjete zgjidhje sepse ka pas neglizhencë mes partive. Paraqiti çështjen e ndërmarrjes publike për tu funksionalizuar BVI ne e banesave qe jap llogari për taksat e qytetareve ajo pyeti se pse nuk po behet konkurs publik për bashkësitë lokale te zgjedhin përfaqësuesit . Secilit qytetare qe paguan taksa komunale duhet ti epët vlerësim dhe transparencë.

Selim Pacolli nënkryetar besojë që Habibi do të referojë për çështjet e ngritura nga Vesa.

Habib Qorri Udhëheqës i sektorit SHP problemi i parkingjeve është shprehur si problem prej pasluftës presim zgjidhje me afatgjate me themelimin e kompanisë "Prishtina Parking" në DSHPMSH punojmë në lirim e atyre hapësirave publike ku kemi bere një kufizim te tyre me shtyllat antiparking dhe 50% te problemit e kemi zgjidhur dhe është konsideruar si një zgjidhje e mire nga qytetaret sepse janë liruar trotuaret për këmbësorë ,por me biznese kemi pasur ankesa dhe ne duhet te jemi mes dy zgjidhjeve.

Faqe 3 nga 5

Selim Pacolli –nënkryetar kemi problem konkret shtyllat anti parking, por 900 parkingje të lira por jemi në tentative për rritjen e tyre. Çështja e mbeturinave është shumë komplekse përmendi rritjen e numrit të banorëve 400 mijë në Komunën Prishtinë, 100 mijë banorë me automjete hynë në kryeqytet të cilët i len mbeturinat dhe nuk janë rezident. Kapaciteti i Kompanisë "Pastrimi" 3 here në ditë bene mbledhjen e mbeturinave. Çdo ditë po rritet numri i banorëve përmendi Hajvalin ku tash ka 20 mijë banorë nga çdo pjesë është duke u rritur në jemi dëshmitarë të gjithë për ndërtimet e reja.

Vesa Kelmendi- tha se çdo mundësi mund me pas komuna çështja e shëndetësisë është në nivel të mirë rritet qyteti po komuna duhet të ketë zgjidhje. Problemi për Ligjin për Prishtinën është e zgjidhur.

Bekim Zogjani –stacioni policor- Qendra- rreth procesit të tërheqjes së veturave po kemi probleme dhe po shkaktohet një gjendje kaotike jemi duke vazhduar por do të jete e përkohshme. Pika e dytë zhurma e lokaleve deri në orët e vona, tash jemi hy në zonën e verës kemi fluksin më të madhe të qytetarëve dhe ardhja e bashkatdhetarëve tanë dhe po kemi tejkalime të orarit të punës së lokaleve. Kërkojë bashkëpunim me Komunën si në asistim me Inspeksionin si dhe për lejet e lëshuar për hapësira publike të kemi një kopje sepse gjer sa ta vërtetojmë a ka pëlqim po na merr kohe, përmendi rreth "Birra festë" patëm problem rreth datave me caktimin e dy datave.

Gani Berisha stacioni policor jugu paraqiti problemin e diskotekave që po tejkalojnë orarin dhe kërkojë asistim të Inspeksionit në mbajtjen e rendit, pastaj kemi pas problemin e qytetarëve me BVI-në lidhur me disa shërbime.

Safet Jashari stacioni policori i veriut tha se duhet të përhapen informacione për këshillime të qytetarëve kanë filluar në fshatin Mramor, Slivovë të rritet numri i KLSP ve e të cilat mund ta fuqizojnë sigurinë dhe të zgjidhen probleme familjare, konflikte të ndryshme dhe munde të shfrytëzojnë zyrat e policisë dhe në stacionin e ri policor mund ta lëmë një zyre për këshillime, takime të ndryshme për siguri.

Xheladin Fazliu Imami i fshatit Hajvali i përshëndeti të pranishmit i cili është edhe përfaqësues i KLSP tha se gjendja e sigurisë është e qete, patëm festën e bajramit pa asnjë eksces dhe në i përkrahim këto iniciativa për ngritjen e sigurisë.

Sasha Mitrovic ngriti çështjen e gropimit të kafshëve të ngordhura të cilat mund shkaktojnë ndonjë epidemi të eliminohet kjo dukuri e shëmtuar.

Selim Pacolli –nënkryetar tha se këtë çështje e ngriti edhe Hetem Kupina –Përfaqësues i hu KLSP-së të fshatit Bardhosh.

Lulzim Shehu për diskutimet që dëgjova tha se i vjen mirë lidhur çështjen e sigurisë që u ngiten nga akte retë e ndryshëm të sigurisë për iniciativat që do ta përmirësonin sigurinë në sfera të ndryshme, kthimi i pjesëmarrësve në luftërat të huaja mendoje se Bashkësia Islame mund të ndikojë në këtë çështje gjatë tubimeve të xhematit në xhamia.

Xheladin Fazliu Imami i fshatit Hajvali nga MPB i kemi marrë informatat për ti ndihmuar familjet e këtyre viktimave dhe kemi pa se shumica kanë shkuar për shkak të kushteve të vështira ekonomike të cilat familje i kemi ndihmuar me 200 pako ushqimore, nuk mendoj se religjioni i ka nxitur për atë rrugë.

Selim Pacolli –nënkryetar tha se ata mbajnë në supet e tyre fajin dhe në nuk mund ti renojmë me shumë dhe se organet përkatëse merren me këtë çështje.

Safet Jashari stacioni policor i veriut nuk po flasim ne për masat qe janë ndërmarrë ndaj tyre por janë shume viktima janë pasoje familjaret e tyre.

Violeta Hasani përfaqësuese e KLSP Qendra falënderon Komunën e Prishtinës dhe stacionin policor Qendra për bashkëpunim po shoh ndryshime pozitive ne çështjen e sigurisë. Si KLSP identifikim i problemit është zhurma e një lokali pavarësisht qe shumica janë përmirësuar , ky i pari ende vazhdon me organizimin e mbajtjes se muzikës live- muzikë e gjalle ne mesin e banoreve , ku për banoret është pengese qe ta kenë një jete normale. Njëherit kërkon qe ne bashkëpunim me Komunën te shi qohet mundësia e vendosjes se një laure në Lagje . Përfundon fjalimin duke thënë Komuna e Prishtinës -Stacioni Qendra për punët e kryera janë për çdo lëvdatë.

Procesmbajtjsja

Hateme Gashi

Kryesuesi i Mbledhjes së KKSb-së

Shpend Ahmeti

